

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 796 Prot.

Tiranë, më 26.11 2015

VENDIM Nr. 115, datë 18.11.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "*Për Trashëgiminë Kulturore*" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "*Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje*" pika 4/d, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.14, të datës 18.11.2015, pasi shqyrtoi *Kërkesën nga ALUIZNI Vlorë* për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit të z. Astrit Meçaj, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Kërkesën nga ALUIZNI Vlorë*, për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit të z. Astrit Meçaj, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO